



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL**  
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 1065 Prot.

Patos, më 19 04 /2024



**PROJEKTVENDIM**

Nr. 37, datë 19 04 /2024

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT “NGRITJA E SHËRBIMIT PËR FUNKSIONIMIN E QENDRËS MULTIFUNKSIONALE” DHE VLERËN E BASHKËFINANCIMIT TË TIJ**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Vendimit nr.81 datë 18.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Patos “Mbi miratimin e numrit të punonjësve dhe buxhetit për vitin 2024” ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 111, datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, V.K.M nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe bazuar në Udhëzuesin për Fondin Social 2024 “Për paraqitjen e kërkesave për njësitë e qeverisjes vendore”, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

- I. Miratimin e projektit “Ngritje e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale” me vlerën 13,008,000 (trembëdhjetë milion e tetë mijë) lekë për 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.
- II. Miratimin e vlerës së bashkëfinancimit për projektin “Ngritje e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale” në shumën 5,540,760 (pesë milion e pesëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë për 3 (tre) vite.

- III. Vlera e bashkëfinancimit prej 922,080 (nëntëqind e njëzetë e dy mijë e tetëdhjetë) lekë për vitin 2024 do të përballohet brenda Programit Buxhetor Përkujdesje Sociale në fondin e pashpenzuar të zërit buxhetor “Bashkëfinancim projekti RELOAD”.
- IV. Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2025-2026 do të buxhetohet në Programin buxhetor afatmesëm 2025-2027.
- V. Vendimi hyn në fuqi sipas ligjit.

**Ekipi i Menaxhimit të Programit**

Barie Goxhaj

Grisilda Bektashi

Fabjola Dervishaj

Anisa Kripa

Edona Beqaj

**Koordinatori i GMS**

Ina Sauli

**Sekretare e GMS**

Mimoza Shtëmbari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 1065 Prot.

Patos, më 19/10/2024

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT “NGRITJA E SHËRBIMIT PËR FUNKSIONIMIN E QENDRËS MULTIFUNKSIONALE” DHE VLERËN E BASHKËFINANCIMIT TË TIJ

Mbështetur në ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 111, datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, V.K.M nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” si dhe bazuar në Udhëzuesin për Fondin Social 2024 “Për paraqitjen e kërkesave për njësitë e qeverisjes vendore” në muajin Nëntor 2023, Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social aplikoi pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me projekt-propozimin “Ngritja e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunkionale” i cili u miratua me shkresën me nr. 807/8 prot., datë 12.02.2024.

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë së jetesës për fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të shërbimit psiko-social dhe terapeutik në qendrën multifunkionale. Me ngritjen e këtij shërbimi shoqëror synohet aftësimi me qëllim rritjen e potencialit të fëmijës si dhe integrimin në jetën shoqërore. Target grupi i synuar për përfitimin e shërbimit në qendër janë 40 fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët trajtohen me pagesë të aftësisë së kufizuar.

**Objektivat e këtij projekti janë:**

**Objektivi 1:** “Të përmirësojë aftësitë e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të pasur një jetë më të pavarur dhe cilësore”.

**Objektivi 2:** “Të mbështesë familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara duke i dhënë njohuri mbi diagnozat e ndryshme si dhe të forcojë lidhjet midis familjeve që përjetojnë të njëjtën situatë”.

**Objektivi 3:** “Të ndërtojë një model të ri dhe të qëndrueshëm të trajtimit të kësaj kategorie në Bashkinë Patos, duke rritur numrin e stafit dhe kapacitetet profesionale të stafit që do të angazhohet”.

**Objektivi 4:** “Të menaxhohet projekti në mënyrë efektive për realizimin e qëllimit dhe aktiviteteve të tij si dhe menaxhimin financiar”.

Kohëzgjatja e projektit do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj dhe vlera totale do të jetë 13,008,000 (trembëdhjetë milion e tetë mijë) lekë prej të cilave vlera 7,467,240 (shtatëmilion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzetë) lekë do të jetë financim nga MSHMS dhe vlera 5,540,760 (pesë milion e pesëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë do të jetë bashkëfinancim nga buxheti i bashkisë. Vlerë ku kjo e fundit ndahet në vitin 2024 në 922,080 (nëntëqind e njëzetë e dy mijë e tetëdhjetë) lekë, për vitin 2025 në vlerën 1,679,520 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzet) lekë dhe në vitin 2026 në vlerën 2,939,160 (dy milion e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë. Vlera e bashkëfinancimit do të mbulohet për vitin 2024 nga Programi Buxhetor Përkujdesje Sociale konkretisht nga zëri buxhetor “Bashkëfinancim projekti RELOAD” dhe vlera e bashkëfinancimit për vitin 2025-2026 do të buxhetohet në Programin buxhetor afatëmesëm 2025-2027, për sa më sipër kërkojmë nga Këshilli Bashkiak:

- I. Miratimin e projektit “Ngritje e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale”.
- II. Miratimin e vlerës së bashkëfinancimit për projektin “Ngritje e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunksionale” në shumën 5,540,760 (pesë milion e pesëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë.
- III. Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2024 do të përballohet brenda Programit Buxhetor Përkujdesje Sociale në fondin e pashpenzuar të zërit buxhetor “Bashkëfinancim projekti RELOAD”.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social.
- V. Vendimi hyn në fuqi sipas ligjit.

**Ekipi i Menaxhimit të Programit**

Barie Goxhaj

Grisilda Bektashi

Fabjola Dervishaj

Anisa Kripa

Edona Beqaj

**Koordinatori i GMS**

Ina Sauli

**Sekretarë e GMS**

Mimoza Shtëmbari

**KRYETARI**

Fation Duro